



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2024

Shtojca 12.

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data 27/12/2024.

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) ose

Operatorit Ekonomik “DESARET COMPANY” Shpk, me Nuis K01816001J dhe me adrese Njesia Bashkiake nr. 11, Rruga "Hysni Gerbolli", Pallati "Desaret", Prane Kryqit te Kuq, Kati perdhe, Tirane.

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)

- OE/BOE me nënkontraktor

PO **JO** **X**

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO **JO** **X**

Tipi i Kontratës: Pune.

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur e Thjeshtuar.

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-32201-12-05-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Punime mbrojtje nga perroi Gryke Manati”.

Kohëzgjatja e kontratës: 30 dite nga data e nenshkrimit te kontrates.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 06/12/2024.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 85, datë 10 Dhjetor 2024.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “DESARET COMPANY” SHPK, me Nuis K01816001J dhe me oferte ekonomike 5,393,700 (pesë milion e treqind e nëntëdhjetë e tremijë e shtatëqind) Lek pa Tvsh,

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

2. Operatori Ekonomik “ORNIAD” SH.P.K, me Nuis J68423509H dhe me oferte ekonomike 5,565,408 (pese million e peseqind e gjashtedhjetë e pese mijë e katerqind e tete) Lek pa TVSH,

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

I- Operatori Ekonomik “ORNIAD” SH.P.K, me Nuis J68423509H,

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Se pari nuk ka paraqitur vertetim xhiro dhe dokumentacion per pune te ngjashme.

Se dyti, nuk ka paraqitur dokumentacion per stafin teknik, mbeshtetes, mjetet dhe isot e kerkuara ne DST.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë

që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “ORNIAD” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “ORNIAD” SH.P.K me Nuis J68423509H, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “DESARET COMPANY” Shpk, me Nuis K01816001J dhe me adrese Njesia Bashkiake nr. 11, Rruga "Hysni Gerbolli", Pallati "Desaret", Prane Kryqit të Kuq, Kati perdhe, Tirane, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 5,393,700 (pesë milion e treqind e nëntëdhjetë e tremijë e shtatëqind) Lek pa Tvsh është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

KRYETARI

Pjerin NDREU